



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE**

# **RAPORTI VJETOR 2012**



## **PËRMBAJTJA**

AKRONIMET .....	3
MESAZHI I DREJTORIT .....	4
HYRJE.....	6
Misioni.....	7
Vizioni.....	7
KAPACITETET NJERËZORE DHE TEKNIKE .....	8
Misioni EULEX në NJIF dhe bashkëpunimi me institucionet tjera .....	9
KORNIZA LIGJORE.....	10
PRANIMI, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE NË LIDHJE ME SHPËLARJEN E PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT .....	11
Përpunimi i raporteve të transaksioneve të dyshimta .....	11
TIPOLOGJI.....	24
BASHKËPUNIMI .....	28
Bashkëpunimi vendor ndërinsitucional .....	28
Bahkëpunimi ndërkombëtar .....	29
PROJEKTET .....	29
ZGJERIMI I VETËDIJES, KËSHILLIMI DHE TRAJNIMI I SUBJEKTEVE  RAPORTUESE DHE INSTITUCIONEVE TJERA TË ZBATIMIT TË LIGJIT .....	30
TRAJNIMET .....	30
Bashkëpunimi me Zyrën për Asistencë Teknike të Thesarit Amerikan.....	32
Takimet me subjektet raportuese .....	32
Takimet me institucione të zbatimit të ligjit.....	33
OBJEKTIVAT E NJËSISË PËR INTELIGJENCË FINANCIARE PËR VITIN 2013.....	33

## **AKRONIMET**

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
MF	Ministria e Financave
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
AKI	Agjensioni Kosovar për Inteligjencë
EULEX	Misioni i Bashkimit European për sundimin e ligjit në Kosovë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OJQ	Organizatrat Joqeveritare
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit të gatshëm (kesh)
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatim të ligjit

## MESAZHI I DREJTORIT



Kam nderin dhe privilegjin që këtë vit të prezantojë raportin e dytë vjetor nga Njësia për Inteligjencë Financiare dhe njëkohësisht raportin e parë vjetor nga transferimi i kompetencave nga strukturat ndërkombëtare tek ato vendore.

Luftimi efektiv i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit mbetet njëra ndër sfidat kryesore të vendeve të Ballkanit perëndimor. Kjo dukuri negative është shqetësim mjaft i madh sidomos i vendeve të cilat kalojnë nëpër një periudhë tranzicioni, me ç'rast kjo dukuri mund të marr përmasa shumë negative për ekonominë e vendit. Kosova si një vend i dalë nga konflikti dhe duke kaluar në procesin e tranzicionit të gjatë ekonomik e social nuk ka mbetur pa qenë e kërcënuar nga mundësia e keqpërdorimit ekonomik e financiar me qëllim të shpëlarjes së parave apo financimin e terrorizmit.

Mungesa e një legjislacioni adekuat në të kaluarën, ka bërë që Kosova të jetë cak i futjes së fondeve me origjinë të panjohur dhe të dyshimtë. Vendi ynë është përpjekur dhe është në rrugë të fuqizimit të mekanizmave ligjor e institucional për luftë sa më efektive të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Efektet e pastrimit të parave mund të jenë me pasoja të rënda në mjedisin e biznesit dhe në ekonominë e vendit në përgjithësi.

Dua të nënvizoj se Njësia për Inteligjencë Financiare edhe gjatë vitit 2012, përmes aktiviteteve të saj sipas ligjit në fuqi ka luajtur rol mjaft efektiv në parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Ky vit e ka karakterizuar institucionin me rritje më të madhe të vetëdijes dhe efektivitetit sa i përket raportimit nga ana e subjekteve raportuese dhe rritjes mjaft signifikante të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Ky vit poashtu karakterizohet edhe me intensifikimin e përpjekjeve për përmirësimin e kornizës ligjore, për krijimin e një ambienti sa më të pafavorshëm për kryerjen e aktiviteteve të paligjshme më qëllim të shpëlarjes së parave apo financimin e terrorizmit.

  
**Dardan NUHIU**

***Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare***

## HYRJE

Njësia për Inteligjencë Financiare – NJIF-K, është institucion qendror kombëtar për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve në lidhje me dyshimet potenciale për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit dhe nxitës apo promotor i parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie. Si një institucion administrativ i themeluar nën autoritetin e Ministrisë së Financave, NJIF-K shërben si një "urë" e rëndësishme ndërmjet sektorit privatë dhe publik. NJIF ka një buxhet të dedikuar dhe pavarësinë e plotë vendimmarrëse në çështjet që janë të rregulluara me ligjin 03/L-196, "Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit".

Ky raport reflekton aktivitetin e përgjithshëm të njësisë për vitin 2012, duke u fokusuar në çështjet kryesore të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës ligjore, aktiviteteve operative, bashkëpunimit dhe rritjes së vetëdijes në lidhje me dukurinë e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Në mbështetje të zbatimit të mandatit të saj të përcaktuar me ligj, Njësia për Inteligjencë Financiare në mënyrë të vazhdueshme ka përcjellur informacione të rëndësishme tek institucionet tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me dyshime potenciale për përfshirje në shpëlarje të parave, financim të terrorizmit apo ndonjë vepër tjetër të ndërlidhur penale kundër ekonomisë.

Njësia për Inteligjencë Financiare në vitin 2012 është angazhuar mjaft shumë në aspekt të përmbushjes së kriterëve kryesore të vëndit tonë sa i përket fushës së parandalimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë pjesë në përpilimin e shumë dokumenteve, pjesëmarrjen në shumë takime me ekspertë europian e ndërkombëtarë dhe duke ofruar kontributin në shumë dokumente strategjike nacionale.

## Misioni

Misioni i Njesisë për Inteligjencë Financiare është që nëpërmjet mandatit të saj ligjor, të jetë udhëheqëse në përmirësimin e sistemit të gjithmbarshëm vendor në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i mirëfilltë i këtij sistemi, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërinstytucional dhe aktiviteteve të Njesisë për Inteligjencë Financiare është objektiv kryesorë e NJIF-K.

Në këtë kontekst, mund të themi se edhe viti 2012 ishte në mbështetje të përmbushjes së këtyre objektivave, ku aktivitetet e Njesisë të përshkruara në mënyrë statistikore e vërtetojnë këtë.

## Vizioni

Me qëllim të sigurimit të promovimit të pajtueshmërisë me Ligjin në fuqi mbi Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financiamin e Terrorizmit, NJIF-K synon që në vazhdimësi të bëjë ngrtjen e kapacitetet operacionale, kapacitetet dhe shkathtësitë analitike të stafit të NJIF-K lidhur me metodologjitë e avancuara të analizimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative me qëllim të arritjes së një kualiteti sa më të lartë të të dhënave të ndjeshme financiare të cilat prahen nga subjektet raportuese të NJIF-K dhe analizimit sa më të saktë të tyre.

Po ashtu synon krijimi e një kornize ligjore (hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ligjore) në harmoni me rekomandimet dhe standartet ndërkombëtare dhe evropiane të cilat do të ndihmojë NJIF-K që ti bashkohet institucioneve të njohura ndërkombëtarisht siç janë EGMONT Group, MONEYVAL, FATF, dhe të tjera.

Ngritja e bashkëpunimit dhe koordimit me institucionet e zbatimit të ligjit për parandalimin dhe luftimin sa më efektiv të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit si dhe ngritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me agjencitë homologe evropiane dhe ndërkombëtare si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave më të mira në këtë fushë është synim i vazhdueshëm nga ana e NJIF-K.

Vizioni i NJIF-K është që në një të ardhme të afërt të pozicionet si një ndër Njësitë për Inteligjencë Financiare më të kompletuara në rajon sa i përket aspektit legjislativ dhe organizativ si dhe njëkohësisht të arrijë që të anëtarësohet në organizatat e njohura ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe.

## **KAPACITETET NJERËZORE DHE TEKNIKE**

Rekrutimi i personelit të ri dhe plotësimi i pozitave profesionale në NJIF-K ka vazhduar edhe gjatë vitit 2012 si pjesë e tranzicionit të këtij institucioni nga misioni i EULEX-it tek autoritetet vendore. Stafi i NJIF-K gjatë vitit 2012 ka arritur një ngritje nga 14 në 18 punonjës ndërsa rekrutimi do të vazhdojë deri në plotësimin e gjithsej 20 pozitave të aprovuara.

Sa i përket aspektit teknik të funksionimit NJIF-K tanimë posedon një sistem të avancuar të teknologjisë informative i quajtur goAML i cili është softuer i krijuar nga Kombet e Bashkuara - Zyra për Kontroll të Drogave dhe Parandalimit të Krimit “United Nations Office on Drugs and Crime” (UNODC) dhe që në vete ngërthen operacione mjaft të sofistikuara që kanë të bëjnë me raportimin dhe analizimin e të dhënave për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Ky sistem mundëson raportimin të drejtpërdrejtë (online) të subjekteve raportuese të NJIF-K si dhe komunikim të koduar (encrypted) me subjektet raportuese dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, dhe institucionet homologe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2012 me qëllim të shfrytëzimit maksimal të vetive të avancuara të sistemit goAML NJIF-K ka bërë edhe disa investime përmes të cilave ka bërë përmirësimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative.



## Misioni EULEX në NJIF dhe bashkëpunimi me institucionet tjera

Njësia për Inteligjencë Financaire edhe gjatë vitit 2012 është angazhaua për të vazhduar dhe ngritur bashkëpunimin ndër-institucional.

Pas përfundimit të tranzicionit dhe bartjes së kompetencave, në Njësinë për Inteligjencë Financiare ka vazhduar prezenca e stafit të misionit të EULEX-it, mirëpo në numër më të vogël. Tre punonjës të misionit të EULEX-it, një këshilltar i Drejtorit të NJIF-K dhe dy analistë të Inteligjencës vazhdojnë të japin kontributin e tyre duke ndihmuar institucionin në zbatimin e mandatit ligjor dhe ngritjen e bashkëpunimit dhe kapaciteteve në fushën e parandalimit dhe luftimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

NJIF-K po ashtu vazhdon të bashkëpunon në mënyrë reciproke me institucionet dhe organet tjera në Kosovë me qëllim që të ndihmojnë njëra tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme.

Sa i përket bashkëpunimit me Policinë e Kosovës me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit të mëtutjeshëm, NJIF-K planifikon që të nënshkruaj Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave ku do të përfshihet edhe bashkëpunimi dhe shkëmbimin "online" i drejtpërdrejtë i informatave me njësitë përkatëse të policisë.

Sa i përket bashkëpunimit me Prokurorin e Shetit gjithashtu planifikohet të fuqëzohet ky bashkëpunim përmes krijimit të mekanizmave adekuat, ndërsa me Doganat e Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës tanimë një bashkëpunim dhe koordinim reciprok ekziston dhe funksionon në mënyrë të mirëfillët në baza ditore përmes shkëmbimit të informatave në mënyrë elektronike dhe koordinimit të aktiviteteve në mes të institucioneve nëpërmjet zyrtarëve ndërlidhës.

NJIF-K nga Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore ka nga një zyrtar ndërlidhës të cilët në baza ditore bashkëveprojnë dhe koordinojnë aktivitetet me interes të ndërsjellë.

## KORNIZA LIGJORE

Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2012 ka vazhduar përpjekjet intensive për identifikimin e mangësive kryesorë të ligjit ekzistues dhe ka porpozuar plotësim-ndryshimin e tij me qëllim të përafërimit të këtij ligji me direktivat e Bashkimit Europian dhe standardet e FATF-it.

Që nga momenti i miratimit të ligjit 03-L/196, “Për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit” në dhjetor 2010 janë vërejtur mangësi në aspekte të ndryshme, të cilat e pengojnë mandatin e Njesisë së Inteligjencës Financiare. Mangësitë kryesore kryesisht ishin tek aspekti i raportimit të subjekteve raportuese, aspekti i inspektimit të këtyre subjekteve dhe disa mangësi tjera teknike të cilat e vështirësonin ushtrimin e mandatit të NJIF-it në mënyrë sa më efektive në aspektin e parandalimit dhe luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

Me këtë rast, me iniciativë të NJIF-it dhe na bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Zyrën për Asistencë Teknike të Thesarit Amerikan nga mesi i vitit 2011 është formuar grupi punues, i cili do ta rishikonte këtë ligj dhe do të rekomandonte për ndryshimet kryesore që duhet t’i bëheshin këtij ligji. Përfundimisht rekomandimet dhe propozimet për plotësim-ndryshim të këtij ligji u hartuan nga zyra ligjore e Ministrisë së Financave dhe u dërguan për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2012.

## PRANIMI, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE NË LIDHJE ME SHPËRLARJEN E PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT

### Përpunimi i raporteve të transaksioneve të dyshimta

Njësia për Inteligjencë Financiare bazuar në mandatin e saj ligjor, edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar me zbatimin e aktiviteteve të saj operative , kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpërlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit.

Siç e kemi cekur edhe në raportin vjetor të vitit 2011, NJIF-K ka krijuar dhe menaxhon bazën e të dhënave me anë të së cilës bëhet pranimi i raporteve nga subjektet raportuese ligjërisht të detyruara për raportim. NJIF ka vazhduar pranimin në mënyrë elektronike të raporteve të transaksioneve të dyshimta (RTD) dhe raporteve të te gatshmeve (keshit) RTG<sup>1</sup>. Përveq raportimeve online që këtë e mundëson ky sistem komunikimi, NJIF përmes këtij sistemi shkëmben edhe informacionet me institucionet tjera të zbatimit të ligjit si, Administratën Tatimore të Kosovës, Doganën e Kosovës etj.

Pjesa më kryesore e sistemit të menaxhimit të të dhënave qëndron në mundësinë e aplikimit të analizave të informacioneve të ndryshme të cilat janë në dispozicion në lidhje me dyshime potenciale të shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Investime të konsiderueshme janë bërë edhe në sistemin e teknologjisë informative gjatë vitit 2012, duke rritur kapacitetin dhe efikasitetin e sistemit, ku me anë të softverëve dhe programeve të ndryshme është krijuar mundësia për raporte dhe statistika më të detajizuare dhe njëkohësisht për monitorim më të efektshëm të parasë së gatshme.


<sup>1</sup> RTD - Subjektet raportuese, përmes zyrtarëve të tyre të përputhshmërisë, duhet të raportojnë në NJIF të gjitha transaksionet të cilat mund të konsiderohen si të dyshimta dhe mund të kenë lidhje me shpërlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe/ose veprave të tjera penale, në bazë të disa listave të indikatorëve të cilat u janë ofruar bankave.

RTG – Ashtu siç është e përcaktuar me nenin 22 të ligjit nr. 03/L-196 “Për parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe financimin e terrorizmit”, transaksionet kesh që duhet të raportohen në NJIF janë “të gjitha transaksionet në vlerë prej 10,000.00 € e më shumë. Transaksionet e shumëfishta do të trajtohen si një transaksion individual nëse banka ose institucioni financiar është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10,000.00) euro brenda një dite të vetme.

Siç e kemi cekur edhe me larte, puna operacionale e NJIF-K-se mbeshtetet ne pranimin e raporteve te aktivitetit te dyshimit, raporteve te Kesh-it si dhe ofron informata për institucionet e zbatimit te ligjit. NJIF-K pas pranimi te raporteve të aktiviteteve të dyshimta, ne bazë të dyshimit te arsyeshum hap raste, dhe pas perfundimit të mbledhjes së informatave dhe analizimit te tyre e bën shpërndarjen e raporteve të inteligjences tek institucionet e zbatimit te ligjit.

Ne baze të statistikave të meposhtme, numri i rasteve te hapura ndryshon nga numri i raporteve te mbyllura për arsye se një pjesë e rasteve barten nga vitet paraprake për shkak te natyrës apo volumit te rastit.

Numri i raporteve të transaksionit të dyshimtë (RTD) nga subjektet raportuese për vitin 2012 arrin në 202 raporte të pranuar. Nga këto raporte të pranuar, 62 prej tyre janë hapur raste të dyshuara dhe pjesa tjetër mbetet në fazën e analizimit për t’u dorëzuar potencialisht në vitin 2013.



Grafiku 1 – Numri i RTD-ve të pranuar

Siç shihet ne figurën më lart, vërehet një rritje substanciale e numrit të raporteve të raportuara në NJIF-K për vitin 2012 në krahasim me vitin paraprak.

Ne baze te selektimit të të dhënave numri me i madh i raportimeve sa i përket transaksioneve te dyshimta raportohen nga Bankat Komerciale dhe një pjesë nga Agjensionet për transfer të parave.

Bankat	Numri i RTD-ve 2012
Bank 1	54
Bank 2	4
Bank 3	7
Bank 4	25
Bank 5	28
Bank 6	36
Bank 7	42
Bank 8	0
Gjithsej	196

*Tabela 1 – Numri i RTD-ve të raportuara nga të gjitha bankat në vend*

Tabela e mësipërme tregon për shifra të ndryshme të numrit të raportimit të Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë nga Bankat Komerciale të vendit. Mund të konkludojmë se ky variacion i raportimit, vjen si rezultat i mungesës së legjislacionit të kompletuar dhe zbrazësirave ligjore të ligjit kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Si pasojë e kësaj, ka rezultuar edhe me mungesën e zbatimit të masave adekuate të mbikqyrjes dhe kontrollit të institucioneve financiare nga mekanizmat mbikqyrës.

Në vendin tonë për momentin operojnë 8 (tetë) banka komerciale, të cilat raportojnë në Njësinë për Inteligjencë Financiare sipas obligimeve të tyre me ligj, dhe ku nga ato NJIF-K kërkon informacione shtesë në lidhje me dyshime potenciale për shpëlarje të parave apo financim të terrorizmit.

Sa i përket numrit të transaksioneve të dyshimta të pranuar nga agjensionet për transfer parash ai është dukshëm më i vogël se sa numri i raporteve të tilla të pranuar nga bankat .

Agjensionet për Transfer Parash	Numri i RTD-ve 2012
ATP 1	3
ATP 2	3
ATP 3	0
ATP 4	0
ATP 5	0
<b>Gjithsej</b>	<b>6</b>

Tabela 2: RTD Agjensionet për Transfer të parave

Njësia për Inteligjencë Financiare në bazë të ligjit në fuqi është e obliguar që pas mbledhjes dhe analizimit të informatave apo transaksioneve të dyshimta, të hap raste sipas dyshimit dhe bën shpërndarjen e rasteve tek institucionet e zbatimit të ligjit . Numri i rasteve të përfunduara në vitin 2012 ka qenë 63 raste, duke mospërfshirë në këtë shifër edhe kërkesat për informata nga institucionet e zbatimit të ligjit. Një pjesë e këtyre rasteve të mbyllura është bartur nga vitet e kaluara (siç është shpjeguar më lartë tek puna operationale) ndërsa pjesa tjetër ka rezultuar nga RTD e vitit 2012

Raportet e dërguara tek institucionet	2011	2012
Policinë e Kosovës	19	15
Policia e Kosovës/Administrata Tatimore e Kosovës	3	7
Policia e Kosovës/Dogana e Kosovës	0	3
EULEX	8	7
Prokurorin e Shtetit	0	1
Administrata Tatimore e Kosovës	3	10
Dogana e Kosovës	2	2
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	1	0
FIU ndërkombëtare	4	0
Raporte të Inspektiveve	2	4
Raste të mbyllura dhe të pashpërndara	20	14
<b>Gjithsej rastet e mbyllura</b>	<b>62</b>	<b>63</b>

Tabela 3: Numri i Rasteve të mbyllura nga NJIF-K

Gjatë vitit 2012, Njësia për Inteligjencë Financiare pas pranimit të Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta nga subjektet raportuese, ka hapur 62 raste dhe pas analizimit të tyre ka rezultuar se ka bazë të mjaftueshme të dyshimit për shpëlarje të parave, financim të terrorizmit apo vepër tjetër penale. Këto informacione janë shpërndarë në formë të raporteve të inteligjencës tek institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Sa i përket hapjes së rasteve dhe përcjelljes së tyre tek institucionet tjera, ky vit karakterizohet me aplikimin e metodës së vlerësimit të kualitetit nga ana e NJIF-K të raporteve të transaksioneve të dyshimta të cilat janë pranuar në NJIF-K nga subjektet raportuese.


Njëra ndër komponentët kyçe të aktiviteteve operative të Njesisë është edhe përpunimi i kërkesave për informata, të cilat NJIF-K pranon nga institucionet e ndryshme të zbatimit të ligjit, si Policia e Kosovës, Administrata Tatimore, Dogana e Kosovës, Njësi të Inteligjencës Financiare jashtë vendit (FIU) etj. Përgjigjet të cilat ofron NJIF-K në këto kërkesa ndikojnë direkt në përshejtimin e hetimeve kur kanë të bëjnë me të dhëna financiare lidhur me shpërlarjen e parave, financimin e terrorizmit, konfiskimin e pasurisë etj.

Në kuadër të kërkesave për informata, Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2012 ka pranuar gjithsej 113 kërkesa për informata nga institucionet e ndryshme vendore të zbatimit të ligjit dhe të njëjtave u është kthyer përgjigje pasi që informata apo të dhënat janë kompletuar apo analizuar nga ana e NJIF-K. Nëse krahasojmë të dhënat në lidhje me kërkesat e një viti më parë, shihet se në vitin 2012 kemi një ngritje substanciale të numrit të kërkesave të tilla, ku në vitin 2011 kemi pasur 74 kërkesa për informata, ndërsa në vitin 2012 kemi ngritje në numër me gjithsej 113. Kjo ngritje njëherit tregon për një ngritje të bashkëpunimit me institucionet të zbatimit të ligjit, rritjen e besueshmërisë dhe rëndësinë e informacioneve të Njesisë për Inteligjencë Financiare dhe rritjes së profesionalizmit të këtij institucioni.

Në formë tabelare dhe grafike paraqiten të dhënat e institucioneve nga është bërë kërkesa dhe krahasimi në periudhën vjetore 2011/2012.

<i>Kerkesat për informata të pranuar në NJIF-K</i>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Policia e Kosovës	21	28
AKI	0	5
Agjencia Kosovare e Privatizimit	0	1
EULEX	16	15
Prokuroria Speciale e R.Kosovës	4	4
ATK	1	2
Dogana e Kosoves	18	44
BQK	0	0
FIU ndërkombëtare	10	10
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2	2
ILECUs	0	2
KFOR	1	0
RFI të pashpërndara	1	0
<b>Gjithsej</b>	<b>74</b>	<b>113</b>

Tabela 4 - Kerkesat për informata (RFI) të pranuar në NJIF-K 2011/2012



Grafiku 2 - Numri i kerkesave të pranuar



NJIF-K në disa raste gjeneron informata të brendshme dhe të njejtat i bashkangjiten kërkesave të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe shpërndahen sipas vlersimeve të këtij institucioni.


Më lartë janë paraqitur të dhënat e kërkesave për informata të pranuar, përderisa në tabelën e mëposhtme prezantohen të dhënat e kërkesave për informata të shpërndara tek Agjensionet e Zbatimit të Ligjit.

<i>Kerkesat për Informata (RFI) të shpërndara nga NJIF-K</i>	<b>2011</b>	<b>2012</b>
Policia e Kosovës	22	30
Agjensioni i Kosovës për Inteligjencë	0	5
Agjensioni Kosovar i Privatizimit	0	1
EULEX	18	11
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	2	6
Administrata Tatimore e Kosovës	1	2
Agjensioni Kunder Korrupsionit	2	0
Dogana e Kosovës	23	44
Banka Qendrore e R.Kosovës	0	0
FIU ndërkombëtare	11	13
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	3
ILECUs	0	1
Interpol-UNMIK	1	0
KFOR	1	0
Raste të pashpërndara	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>82</b>	<b>117</b>

*Tabela 5 - Kerkesat për Informata të shpërndara nga NJIF-K në Institucionet tjera të zbatimit të ligjit*

Rol të rëndësishëm në mandatin e Njesisë për Inteligjencë Financiare luan edhe shkëmbimi i informacioneve në lidhje me shpëlarjen e parave apo fincimin e terrorizmit me institucionet e ngjashme ndërkombëtare (Njësitë për Inteligjencë Financiare të jashtme). NJIF-K gjatë vitit 2012

ka shtuar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe numri i kërkesave për informata të këmbëra është 13, duke mos përfshirë në këtë rast edhe ndihmën në aspekt këshillimi në rastet që nuk kanë qenë pjesë e misionit të NJIF-K-së. Më drtësisht shih tabelën nr. 8.



Grafiku 3 - Informacionet e shpërndara në FIU ndërkombëtare

Për më tepër, nga analizat statistikore të nxjerra për vitin 2012, në lidhje me kohëzgjatjen e ciklit nga pranimi i kërkesës në NJIF-K deri te shpërndarja tek institucioni përkatës, rezulton se mesatarja e kohëzgjatjes së këtij cikli të punës për vitin 2012 është 38 ditë kalendarike. Ndërsa, nga indikatorët statistikorë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012, rezulton se mesatarja e këtij cikli është zbritur në 30 ditë kalendarike që tregon për rritjen e nivelit të performancës në aspekt të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Njësia për Inteligjencë Financiare, sipas ligjit në fuqi dhe mandatit të saj operativ, pranon raportet e transaksioneve në të gatshme (kesh) në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë nga subjektet raportuese të cilat janë të obliguara që të raportojnë këto transaksione me ligj.

Gjatë vitit 2012 janë raportuar gjithsej 480479 raporte të transaksioneve të parasë së gatshme (kesh), duke arritur shumën totale të transaksioneve të raportuara në NJIF-K në vlerë prej **5,242,591,346** euro. Këtu hyjnë raportimet e të gjitha subjekteve raportuese duke përfshirë edhe Raportet nga Dogana e Kosovës, të cilat ky institucion obligohet t'i raportojë në NJIF-K sipas deklarimeve të personave fizik dhe juridike në pikat kufitare në Republikën e Kosovës.

Në baze të krahasimit me vitin paraprak është shënuar një ngritje e raportimeve të transaksioneve të parasë së gatshme ku rezultatet tregojnë se në vitin 2011 kane qenë të raportuara **423,443** transaksione të parasë së gatshme shprehur në vlerë monetare në shumë prej **4,873,354,867** euro, dhe sipas llogaritjeve shihet një ngritje prej **57,036** transaksioneve të raportuara, përderisa në para kishte një ngritje prej **369,236,479** euro.

<b>Parat në të gatshme të raportuara (RTG) gjatë vitit 2012</b>	
Subjektet Raportuese	2012
Banka & Kembimi Valutor	4,091,992,277
Dogana	1,146,923,166
Institucionet Financiare jo bankare	85,195
Agjensionet për Transfer Parash	3,590,708
<b>Gjithsej</b>	<b>5,242,591,346</b>

*Tabela 6 – Parat në të gatshme të raportuara (RTG) gjatë vitit 2012 nga subjektet raportuese*

Gajtë vitit 2012, Bankat Komerciale përbëjnë pjesën kryesore të raportimit të tranaksioneve në para të gatshme. Duhet theksuar se me funksionalizimin e programit goAML<sup>2</sup>, kualiteti i pranimit të raporteve nga subjektet raportuese ka shënuar një progress të theksuar, kjo falë edhe rritjes së kapacitetve dhe stafit të teknologjisë informative në NJIF-K.

**Paratë e gatshme të raportuara nga Banakat Komerciale**

Bankat	Shuma RTG Euro
Bank 1	147,784,451
Bank 2	158,049,643
Bank 3	168,892,328
Bank 4	526,811,419
Bank 5	1,077,830,988
Bank 6	1,450,996,897
Bank 7	456,814,978
Bank 8	56,968,627
<b>Gjithesj</b>	<b>4,044,149,331</b>

*Tabela 7 - Paratë e gatshme të raportuara nga Banakat Komerciale*

Njësia për Inteligjencë Financiare ka pranuar raporte të parave në të gatshme nga Zyret e Këmbimit Valutor, ku të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e tyre ishin konvertime nga CHF në Euro dhe anasjelltas.

<sup>2</sup> goAML – Softveri i dizajnuar nga UNODC (Zyra e Kombeve të Baskuara kundër Drogave dhe Krimit). Softverë i avansuar, i cili mundëson këmbimin elektronik të informacioneve dhe kryerjen e analizave në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Parat e gatshme të raportuara nga Këmbimoret	
KËMBIMORET	Shuma
KËMBIMORE 1	592,335
KËMBIMORE 2	100,372
KËMBIMORE 3	1,976,734
KËMBIMORE 4	352,256
KËMBIMORE 5	4,261,026
KËMBIMORE 6	1,302,162
KËMBIMORE 7	129,700
KËMBIMORE 8	12,634,285
KËMBIMORE 9	742,184
KËMBIMORE 10	2,727,662
KËMBIMORE 11	1,010,963
KËMBIMORE 12	1,489,959
KËMBIMORE 13	1,089,913
KËMBIMORE 14	3,934,219
KËMBIMORE 15	2,561,063
KËMBIMORE 16	1,827,898
KËMBIMORE 17	3,363,882
KËMBIMORE 18	237,728
KËMBIMORE 19	794,759
KËMBIMORE 20	24,733
KËMBIMORE 21	1,396,072
KËMBIMORE 22	633,079
KËMBIMORE 23	658,803
KËMBIMORE 24	3,426,844
KËMBIMORE 25	574,315
<b>Gjithesj</b>	<b>47,842,946</b>

Tabela 8 - Parat e gatshme të raportuara nga Këmbimoret

Deklarimi I mjeteve monetare në Doganën e Kosovës është zbatuar në harmoni me nenin 29<sup>3</sup> “Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës - Detyrimi për të deklaruar”. Pjesa më e madhe e mjeteve monetare të deklaruara ishin nga Bankat Komerciale dhe Banka Qendrore e Kosoves. Mbi 90 % e deklarimeve në para të gatshme shprehur në vlerë monetare ishin kryer në valutat Euro dhe CHF. Duhet theksuar se gjatë vitit 2012 ishin paraqitur 13 raste të mosdeklarimit apo shmangjes së detyrimit të raportimit, veprime këto për të cilat ishte zbatuar kundërvajtja prej 25% bazuar paragrafin 4 të nenit 29 të Ligjit nr.03/L-196. Krahasuar me vitin 2011 në të cilin vit ishin raportuar transaksione në vlere prej gjithsej 863,399,010.43 Euro. Gjatë vitit 2012 kishte një rritje prej rreth 33% të vlerës së transaksioneve të raportuara nga Dogana e Kosovës.

**Paratë e gatshme të raportuara nga Dogana e Kosovës**

Valuta	RTG Bizneset	RTG Personat Fizik	Kursi valutor	RTG Bizneset Euro	RTG Personat Fizik Euro
1	2	3	4	(2x4)	(3x4)
ALL (Lek)	202,800,000	837,000	139.41	1,454,660	6,004
AUD	156,635		1.28	122,785	
CAD	302,650		1.34	225,890	
CHF	438,299,150	7,705,180	1.23	357,118,885	6,278,053
DIN	4,975,310,000		111.42	44,653,252	
DKK	501,200		7.46	67,225	
EUR	682,270,630	11,772,299		682,270,630	11,772,299
GBP	10,674,235		0.86	12,422,186	
HRK	549,440		7.59	72,353	
NOK	8,914,950		7.45	1,197,258	
RUB	1,500		40.02	37	
SEK	3,274,200	12,000	8.34	392,775	1,440
USD	37,105,965	586,850	1.31	28,417,989	449,445
<b>Nen Total</b>	<b>6,360,160,555</b>	<b>20,913,329</b>		<b>1,128,415,926</b>	<b>18,507,240</b>
<b>Gjithsej</b>				<b>1,146,923,166</b>	

Tabela 9 - Paratë e gatshme të raportuara nga Dogana e Kosovës

<sup>3</sup> LIGJI Nr. 03/L-196.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e numrit të transaksioneve të raportuara nga Agjensionet për Transfer Parash. Kryesisht këto raportime përfshijnë Transaksionet e shumëfishta të cilat janë trajtuar si një transaksion individual. Kjo ishte bërë pasi që institucioni financiar ishte në dijeni se transaksionet janë kryer nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën prej më shumë se dhjetëmijë (10.000) Euro në një (1) ditë të vetme.

<b>Paratë e gatshme të raportuara nga Agjensionet për transfer parash</b>		
<b>Agjensionet për transfer parash</b>	<b>Nr Transaksioneve</b>	<b>Shuma €</b>
ATP 1	881	3,566,813
ATP 2	5	23,894
<b>Gjithsej</b>	<b>886</b>	<b>3,590,708</b>

Tabela 10 - Parat e gatshme të raportuara nga Agjensionet për transfer të parave

Gjatë vitit 2012, NJIF-K ka pranuar një numër shumë të vogël të raporteve në para të gatshme nga institucionet financiare, kjo edhe është e natyrshme për arsye se Institucionet mikrofinanciare bazuar në veprimtarin e tyre kryejn transaksione kryesisht në vlera jo shumë të mëdha.

<b>Parat e gatshme të raportuara nga Institucionet Financiare</b>		
<b>Institucionet Mikrofinanciare</b>	<b>Nr Transaksioneve</b>	<b>Shuma €</b>
IF 1	1	10,000
IF 2	1	10,195
IF 3	6	65,000
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>85,195</b>

Tabela 11 - Parat e gatshme të raportuara nga Institucionet tjera Financiare

## TIPOLOGJI

Njësia për Inteligjencë Financiare në vijim të këtij raporti vjetor të punës, paraqet për herë të parë edhe disa raste të ilustruara, të cilat njehërit paraqesin edhe llojet e rasteve të cilat ndër të tjera janë subjekt i analizave nga Njësia, në lidhje me dyshime potenciale për shpëlarje të parave dhe financim të terrorizmit dhe vepra tjera të ndërlidhura.

### Rasti 1

#### **Transfere të fondeve jashtë vendit të përfituara nga aktivitetet e paligjshme – trafikim me qenie njerëzore.**

Një subjekt raportues ka raportuar një RTD (Raport të transaksionit të dyshimtë) se një person me shtetësi të një vendi tjetër është duke transferuar fonde tek disa persona të ndryshëm pa ndonjë justifikim të qartë ekonomik. Transaksionet janë kryer në një periudhë prej rreth 9 muaj. Pas verifikimeve të kryera për atë periudhë nuk ka rezultuar që personi në fjalë është e punësuar zyrtarisht në Kosovë, por pas një hetimi të kryer, rezultoi që i njëjti person punon në një restaurant në vendin tonë. Fondet e transferuara jashtë vendit kishin një diferencë të theksuar krahasuar me të ardhurat mujore që ai person ka mundur të arkëtonte duke punuar në një restaurant.


Nga konkludimet e dhëna dhe të nxjerra nga analizat financiare dhe pastaj të dërguara për hetim mëtutjeshëm në Agjensionet e Zbatimit të Ligjit, ka rezultuar që në kohën kur ishin duke u zhvilluar hetimet ai person hapi edhe një biznes në Kosovë kjo me qëllim të arsytimit të dërgimit të fondeve jashtë vendit. Nga ai hetim rezultoi se personi në fjalë ishte duke menaxhuar dhe kontrolluar një numër të caktuar të disa femrave të ardhur nga disa vende tjera të njohura për trafikim me qenie njerëzore.




**Rasti 2**

**Investimi i mjeteve në pasuri të patundshme**

Një transaksion në shumë prej €70,000.00 ishte realizuar si tërheqje në para të gatshme dhe e cila shumë më pastaj u depozitua në një llogari bankare, pronar i së cilës ishte një shtetas i huaj. Transaksioni ishte kryer nga një person i cili është bashkëpronarë i një biznesi, dhe kjo ka bërë që në NJIF-K të dorëzohet një RAD/STR (Raport i transaksionit të dyshimtë) i cili më pastaj ka ndikuar që NJIF-K të filloj me procedimin e rastit dhe fillimin e analizave financiare. Duhet cekur se paratë e depozituara më pastaj janë transferuar në një llogari tjetër, prej nga mëtej janë dërguar në një shtet tjetër. Shih skicen e mëposhtme



Vetëm disa ditë më vonë në NJIF-K ishte raportuar edhe një RAD/STR tjetër, dhe i cili kishte të bënte me një transaksion të kryer nga një person i cili vinte nga shteti i njejtë dhe i cili ishte i lidhur me Raportin e transaksionit të dyshimtë të paraqitur më lartë. Shih skicën e mëposhtme:



Gjatë analizimit të transaksioneve nga grumbullimi i informacioneve, evidencohen transaksione tjera të dyshimta, ku njëri nga ato transaksione të dyshimta arrinte shumë mbi gjysmë milioni euro. Poashtu, evidentohej ndërlidhshmëri e personave dhe entiteteve të interfereuara nga këto transaksione. Evidentohet një numër i madhë i bizneseve të krijuara të cilat operojnë në Kosovë me një aktivitet financiarë substancial.

Lëvizjet financiare me shtetin nga e kanë origjinën personat që nuk janë me origjinë nga Kosova janë të mëdha. Evidencohet fakti se transaksionet të cilat kanë shtyer në gjenerim të RAD-ve kanë qenë vetëm fragmente të një aktiviteti të mëdhe financiarë të personave lokal dhe ndërkombëtarë dhe kompanive të ndërlidhura. Kemi të bëjmë me (5) pesë persona lokal të involvuar në këtë rast dhe me tre persona të tjerë të cilët ndërferojnë financiarisht me ta. Personi kyq i involvuar ka aktivitete tjera të cilat e profilizojnë atë si të dyshimtë për shkak të rënjes së tij ndesh me ligjin në disa raste.

Gjithashtu kemi të bëjmë me dymbëdhjetë persona të ndërlidhur financiarisht të cilët operojnë me një numër të madhë biznesesh në Kosovë.

Vërehet dukuria e krijimit të një numri të madhë të bizneseve nga personi lokal dhe mandej blerja a tyre nga ndërkombëtarë. Krahasimi me të dhëna të marra nga Administrata Tatimore zbulon diskrepanca për disa nga kompanitë e përfshira në këtë rast.

**Rasti 3****Lëvizje e mjeteve ndërmjet disa kompanive me të njëjtin pronar dhe integrim i atyre mjeteve përmes sigurimeve në të cilën kompani sigurimesh paraqitet i njëjti person**

Është për tu habitur fakti se si një kompani e cila ofron kurse të ndryshme kryesisht për gjuhë të huaj pranon fonde në vlerë mbi 280,000 € për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Ky fakt ka zbuluar se shumica e atyre mjeteve të pranuar nuk kishin të bënin asgjë me aktivitetin e saj ekonomikë por kryesisht ishin huazimet të rrjedhura nga transaksionet e kryera ndërmjet kompanive të lidhura me njëra tjetrën.

Tri kompani me adresë dhe emra shumë të ngjashëm (Kompania A, Kompania B dhe Kompania C) ishin themeluar në një periudhë të përafërt kohore dhe që të trija kishin pronar dhe bashkëpronar të ndryshëm, që rritë dyshimin se këto kompani janë fiktive, por ato janë të regjistruara me qëllim të komplikimit të hetimeve nga Agjensionet e Zabatimit të ligjit. Përveq se ishin themeluar kompani “fiktive” ato kryenin transaksione tepër të dyshimta me indikator të pastrimit të parave. Një kompani tjetër e cila ofronte shërbime të Sigurimeve dhe e cila kishte bashkëpronar personin e njëjtë që qëndronte pas atyre tri kompanive tjera, kreu një transfer në vlerë prej 374,781.00 € tek Kompania A për pagesën e dëmit të pasurisë së Siguruar. Të dy këto kompani kanë pronar të njëjtin person (Personi A) dhe pastaj pas vetëm disa ditë më vonë Personi A pranoi një shumë të madhe të mjeteve prej 410,000 € për rritjen e kapitalit fillestar në Kompaninë e Sigurimeve. Këto transfere rrisin dyshimin që Kompania e Sigurimit bëri një mashtrim duke paguar 374,781.00 € në emër të dëmit për Personin A, kjo njëherit ndikoj edhe në rritjen e shpenzimeve duke pasur ndikim direkt në pasqyren e të ardhurave përkatësish në fitimin para tatimit, ku me këtë rast në të njëjten kohë e zvogëlon fitimin para tatimit duke i ikur edhe pagesës së tatimit në fitim prej rreth 70,000 €. Kjo në fakt është një skemë e pastrimit të parave sepse vetëm një shumë pakëz më e madhe se sa pagesa e dëmit, ishte kthyer përsëri tek Kompania e Sigurimeve por nëpërmes kanaleve tjera rritjes së kapitalit aksionar në vlerën e cekur më parë (410,000 €) nga personi i njëjtë.

Përveq kësaj, fakti që Personi A ishte pronar i kompanisë e cila ishte e dyshuar për pastrim

parash në një vend tjetër (bazuar në raportin e FIU së shtetit tjetër), dhe Personi B ishte i involvuar në disa aktivitete kriminale (Raporti i Policisë në vendin tonë), si dhe Personi C ka qenë i përfshirë në disa transaksione biznesore me disa vende të njohura si “Offshore Country” tregojnë që këta individë kanë një të kaluar të tyre kriminale dhe dyshimi i lartë i përfshirjes së tyre në aktivitetin e pastrimit të parave.

Rasti ishte dërguar në Agjensionet e Zbatimit të Ligjit dhe rezultatet ishin: tre Persona ishin arrestuar, dy persona tjerë ishin në kërkim, rreth 100,000 Euro mjete monetare ishin konfiskuar, rreth 2 milion euro janë bllokuar, si dhe është gjetur të jetë mbajtur kontabilitet i dyfishtë nga e cila ka rezultuar se kishte pasur një evazion mjaft të madh fiskal

## BASHKËPUNIMI

### Bashkëpunimi vendor ndërinsitucional

Njësia për Inteligjencë Financiare edhe gjatë viti 2012 ka vazhduar bashkëpunimin mjaft të mirë me institucionet tjera të zbatimit të ligjit duke përfshirë ato vendore dhe ndërkombëtare, në luftën për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. NJIF-K me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërinsitucional ka ripërtëritur marrëdhënien e bashkëpunimit me Doganën e Kosovës.

NJIF poashtu ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë aktive në draftimin dhe përpilimin e tri strategjive kombëtare nga Ministria e Punëve të Brendshme:

- 1) Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar,
- 2) Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit dhe
- 3) Strategjinë kombëtare për parandalimin e krimit.

## Bashkëpunimi ndërkombëtar

Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, Njësia për Inteligjencë Financiare pasi që ende nuk është anëtare e organizatave ndërkombëtare siç janë EGMONT Group dhe MONEYVAL, ka ndërmarrë masat për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar duke krijuar marrëveshje bilaterale dhe nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi për këmbim të informacioneve që kanë të bëjnë me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit me shtete të huaja me interes reciprok. NJIF-K gjatë vitit 2012 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me FIU-në e Republikës së Turqisë dhe FIU-në e Republikës Çeke. Bashpëpunimet e NJIF-it me vendet e huaja lidhur me shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe këmbimin e informacioneve lidhur me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit kanë vazhduar në mënyrë intensive edhe gjatë vitit 2012, ku NJIF ka shkëmbyer informacione edhe me shtetet e rajonit dhe shtetet tjera si Holanda, Belgjika etj.

## PROJEKTET

Njësia për Inteligjencë Financiare është bërë pjesë e Projektit Kundër Krimin Ekonomik (PECK), Ky projekt financohet dhe implementohet nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Me anë të këtij projekti, vendit tonë për herë të parë do t'i bëhet vlerësim i gjithmbarshëm i aspektit të parandalimit dhe luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, sipas standardeve ndërkombëtare të FATF (Task Forca e Veprimit Financiar), MONEYVAL dhe GRECO.

NJIF-K në kuadër të këtij projekti është institucion bartës dhe koordinues i komponentës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, ku ka përfunduar me sukses ciklin e parë të këtij projekti që ishte plotësimi i pyetësorit nga të gjitha institucionet në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Përfaqesuesit nga NJIF-K kanë pasur rastin që të takohen direkt me ekspertët nga ky projekt, ku me këtë rast NJIF-it i është bërë një vlerësim fillestar në të gjitha aspektet sipas metodologjisë së institucioneve të lartëpërmendura.

## ZGJERIMI I VETËDIJES, KËSHILLIMI DHE TRAJNIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE DHE INSTITUCIONEVE TJERA TË ZBATIMIT TË LIGJIT

### TRAJNIMET

Me ndihmën e Thesarit Amerikan, Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera relevante Njësia për Inteligjencë Financiare ka mbajtur dhe ka qenë pjesëmarrëse në disa trajnime të ndryshme e po ashtu ka pasur kontakte për këshillim si dhe konsultim lidhur me raportimin e subjekteve duke përfshirë:

- Përmirësimi i kualitetit të raportimit
- Përcjellja e direktivave të NJIF-it
- Forma e raportimit për subjektet e regjistruara gjate këtij viti
- Ndiurma dhe këshillimi sa i përket sistemit të IT-së

Gjatë vitit 2012 është organizuar seminari/Workshop regjional nga Ambasada Amerikane dhe si pjesëmarrës kanë qenë institucionet e zbatimit të ligjit nga vendet e Ballkanit. Qëllimi i këtij seminari ka qenë bashkëpunimi ndërkombëtar në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit pasi që kjo dukuri ka ndikim negativ në ekonominë nacionale e regjionale.

Njësia për Inteligjencë Financiare rëndësi të veçantë i ka kushtuar aspektit të ngritjes profesionale të personelit që merret me analiza në lidhje me dyshimet potenciale të shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Kjo ngritje në aspektin profesional bëhet përmes pjesëmarrjes së stafit të NJIF-it në trajnime dhe seminare të ndryshme, ku kryesisht këto trajnime zyrtarët nga NJIF i kanë vijuar së bashku me zyrtarët e tjerë nga institucione tjera të zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjensoni Kundër Korrupsionit etj. Në tabelën në vijim janë edhe detajet në lidhje me trajnimet e lartëpërmendura:

**Trajnime të mbajtura nga Staf i NJIF në vitin 2012:**

Nr. zyrtarëve nga NJIF	Emri i trajnimit	Lokacioni	Organizuar nga
3	Trade Based Money Laundering	ICITAP	OTA
	Trade Based Money Laundering	ICITAP	OTA
	Trade Based Money Laundering	ICITAP	OTA
1	Advanced Money Laundering Analysis	Hotel "Sirius"	OTA
1	Asset confiscation	ILECU-Kosovo Police	ILECU
1	FIU Regional Symposium	Ohrid, Macedonia	ILECU-IPA
3	Advanced Money Laundering Analysis	Hotel "Sirius"	OTA
	Advanced Money Laundering Analysis	Hotel "Sirius"	OTA
	Advanced Money Laundering Analysis	Hotel "Sirius"	OTA
2	goAML Meeting	Vienna	UNODC
	goAML Meeting	Vienna	UNODC
1	Multi-country seminar on "Cuber Crime, challenges ahead"	Belgium, Brussels	TAIEX, European Commission
2	Counter corrupcion and proffesional ethics	Hotel "Swiss Diamond", Prishtina	
	Counter corrupcion and proffesional ethics	Hotel "Swiss Diamond", Prishtina	
1	Vlerësimi i krimit serioz dhe krimit të organizuar-SOCTA	ICITAP	ICITAP
2	Trajno Trajnerët - Instruktor	Policia e Kosoves-Trajnimet	OTA - instituti kunder krimieve ekonomike
	Trajno Trajnerët - Instruktor	Policia e Kosoves-Trajnimet	OTA - instituti kunder krimieve ekonomike
2	Teknikat e avancuara te hetimeve financiare	Policia e Kosoves-Trajnimet	OTA - instituti kunder krimieve ekonomike
	Teknikat e avancuara te hetimeve financiare	Policia e Kosoves-Trajnimet	OTA - instituti kunder krimieve ekonomike
1	Anti monay laundering and financial investigation ëith specidic refference to advance technique in bank account analysis, offshore banka account movement and VAT frauds	Sarajevo, BH	Komisioni European – TAIEX
2	Luftimi i Terrorizmit	Hotel "Sirius"	Komisioni European – TAIEX
	Luftimi i Terrorizmit	Hotel "Sirius"	Komisioni European – TAIEX
1	Vleresimi i krimit serioz dhe krimit te organizuar-SOCTA	ICITAP	ICITAP
1	Multi country - Ëorkshop on anti mony laundering	Brussels, Belgium	Komisioni European – TAIEX
2	Asset Recovery	Hotel "Sirius"	Ministry of Justice
	Asset Recovery	Hotel "Sirius"	Ministry of Justice

## Bashkëpunimi me Zyrën për Asistencë Teknike të Thesarit Amerikan

NJIF-K ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën për Asistencë Teknike të departamentit të Thesarit Amerikan në Kosovë, duke ofruar ligjërime dhe asistencë subjekteve raportuese dhe institucioneve të zbatimit të ligjit, në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, mandatin ligjor dhe operacional të NJIF-it dhe rëndësinë e mbështetjes nga NJIF për institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Në kuadrin e këtyre bashkëpunimeve Njësia ka qenë pjesëmarrëse e themelimit të Institutit kundër Krimeve Ekonomike i cili është themeluar në shtator të vitit 2012, me iniciativë të zyrës së lartëpërmendur, me qëllim të ofrimit të trajnimit dhe mbështetjes së Institucioneve të zbatimit të ligjit. Në tabelën në vijim janë edhe detajet në lidhje me trajnimet e lartëpërmendura:

*Ligjërimet e ofruara nga Stafi i NJIF në vitin 2012:*

Emri i trajnimit	Lokacioni	Financuar nga
Trade Based Money laundering	ICITAP	OTA
Prevention of Money Laundering and Terrorist Financing	DMTH (Money Gram)	DMTH (Money Gram)
Advanced Techniques against Financial Crime	Kosovo Police	OTA
Advanced Techniques against Financial Crime	Kosovo Police	OTA

## Takimet me subjektet raportuese

Poashtu, në vazhden e bashkëpunimit sa më të ngushtë me subjektet raportuese, NJIF ka aplikuar edhe formën e takimeve individuale me subjektet raportuese, duke u takuar fillimisht me të gjitha bankat komerciale në vend në takime të veçanta dhe me shoqatën e noterëve të Kosovës. Këto takime kanë rezultuar mjaft pozitive, ku janë diskutuar dhe shtjelluar format më të mira të



raportimit dhe NJIF u ka ofruar rekomandime dhe udhëzime për qështje që lidhen përmbushjen e obligimeve ligjore të tyre dhe bashkëpunimin sa më efektiv reciprok.

NJIF-K ka qenë një ndër institucionet udhëheqëse në partneritet me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë në organizimin e konferencës rajonale me temë diskutimin dhe bashkëpunimin ndërshtetëror dhe ndër-institucional në zbatimin e ligjit të shteteve të rajonit.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin disa institucione vendore të zbatimit të ligjit si Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), Prokuroria e Shtetit, Agjensioni për Menaxhmin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë etj., dhe homologët e tyre nga shtetet e rajonit si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia. Kjo konferencë ishte një ngjarje dhe rast i mirë për këmbimin përvojave reciproke dhe diskutimin e mundësive për rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional në nivel ndërshtetëror.

### **Takimet me institucione të zbatimit të ligjit**

NJIF gjatë vitit 2012 ka rritur intensitetin e takimeve me institucionet tjera të zbatimit të ligjit, me qëllim të rritjes së bashkëpunimi ndër-institucional. Njësia për Inteligjencë Financiare ka zbatuar modelin e takimeve periodike me këto institucione, ku janë takuar për çdo muaj në mënyrë reprezentative përgjegjësit nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Prokuroria etj., me ç'rast janë diskutuar çështjet që lidhen ngushtë me mandatin operacional të këtyre institucioneve dhe Njesisë për Inteligjencë Financiare në anën tjetër.

## **OBJEKTIVAT E NJËSISË PËR INTELIGJENCË FINANCIARE PËR VITIN 2013**

Njësia për Inteligjencë Financiare do të vazhdojë aktivitetin e saj të përcaktuar me ligj, në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. NJIF në vitin 2013 do të angazhohet në shumë dimensione në përmbushje të misionit të saj ku ndër te tjera, aktivitetet kryesore do të shtrihen në fushat si në vijim:

- Ngritja dhe fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të NJIF-K për parandalimin sa më efektiv të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, ku kjo mëtohet të arrihet përmes trajnimeve të stafit dhe masave këshilluese për subjektet raportuese.
- Ngritja dhe fuqizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërinstitucional në kuptim të rritjes së efikasitetit të këmbimit të informacioneve me qëllim të luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.
- Mbështetja e vazhdueshme e institucioneve vendore të sigurisë në adresimin e sfidave drejt integriteteve evropiane, gjithashtu edhe sfidave të procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën.
- Shtimi i vazhdueshëm i përpjekjeve për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare si FATF, EGMONT, MONEYVAL etj.
- Plotësimi i një vlerësimi kombëtar të riskut AML/CFT (Shpëlarjes së parave/financimit të terrorizmit).
- NJIF-K po ashtu do të vazhdojë projektet të cilat janë duke u zhvilluar në përmirësimin dhe ngritjen e sistemit të TI-së dhe të zhvillimit të bazave të të dhënave, procedurat e brendshme dhe të jashtme të NJIF-K, ngritjen e vazhdueshme të bashkëpunimit me subjektet raportuese dhe vetëdisimin e tyre rreth obligimeve ligjore mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare (agjencitë tjera homologe) si dhe vazhdimin e plotësimit të infrastrukturës ligjore (hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e dokumenteve strategjike dhe akteve tjera nënligjore) në harmoni me standartet ndërkombëtare dhe evropiane sa i përket kësaj fushe.